



Pranimi / Dorezuar Prilbena / Prodato Received / Delivery	07-07-2022	2	viti god year
Organ / Bješta Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSKICK	3977/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.500/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.500/2022 të datës 06.06.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson avokat me kundër Vendimit me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 07.07.2022 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.500/2022 të parashtruar nga ankuesi më datë 06.06.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 06.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3255/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.500/2022, e plotësuar dhe ndryshuar me shkresën me numër protokolli 3391/2022 të datës 13.06.2022, kundër Vendimit me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktik dhe aplikim të gabuar të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative dhe ligjeve tjera përkatëse të cilat i rregullojnë çështjen e shërbimit të jashtëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 08.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ndërsa Këshilli, me datë 13.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e vendimmarrjes në lidhje me këtë ankesë ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.500/2022 e datës 06.06.2022 me numër protokolli 3255/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës; Vendimin me Nr.Ref:355/2020 të datës 14.07.2020 të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; Emalin e datës 03.06.2022 të ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 08.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datë 13.06.2022; Vendimin me Nr.55/09 i datës 23.11.2009; Vendimin e datës 13.05.2013; Vendimin me Nr. 388/2013 i datës 17.07.2013; Vendimin me Nr. Ref:L389/13 i datës 18.07.013; Vendimin me Nr. 609/2014 i datës 11.11.2014; Vendimin me Nr. 037/2015 i datës 20.10.2015; Vendimin e datës 17.12.2017; Vendimin e vitit 2018; Plotësimin e ankesës me numër protokolli 3391/2022 i datës 13.06.2022 nga ankuesi; Vërtetimin me Nr.05/2018 i datës 20.07.2018; Vendimin me Nr.223/2017 i datës 19.12.2017; Vendimin me Nr.Ref:685/2018 i datës 24.07.2018; Vendimin me Nr.ZSP-39/2018 i datës 30.03.2018; Autorizimin e datës 06.06.2022; Provë shtesë e datës 29.06.202 nga MPJD; Vendimin me Nr. Ref:002/2022 i datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit, është **bërë i pamundur, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale, Kolegji ka gjetur së ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me Vendimin me Nr.Ref:355/2020 të datës 14.07.2020 të Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (tutje referuar si MPJD) është caktuar të shërbej në gradën diplomatike "Këshilltar" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Paris/Republika e Francës me mandat katër (4) vjeçar respektivisht duke filluar nga data 01.08.2020.

Me tej nga shqyrtimi i shkresave të lëndës rezulton së Ambasadori i Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, më datë 23.05.2022 ka nxjerrë Vendimin me Nr.Ref.001 me të cilin ka bërë riorganizimin e punës diplomatike dhe konsullore në kuadër të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Paris, ashtu që ankuesi caktohet të merret me shërbimin konsullor deri në emërimin e një Konsulli apo zëvendës konsulli në të njëjtin shërbim.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo Ambasadori i Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës më datë 29.06.2022 ka nxjerrë Vendim me Nr.Ref:002/2022 me të cilin ka shfuqizuar Vendimit me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022.



Andaj, duke marrë parasysh së objekt kontesti sipas ankesës A.nr.500/2022 është kundërshtimi i ligjshmërisë së Vendimit me Nr.Ref.001 të datës 23.05.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës dhe meqenëse ky vendim është shfuqizuar me Vendimin me Nr. Ref:002/2022 të datës 29.06.2022 të Ambasadorit të Ambasadës së Republikës së Kosovës në Republikën e Francës, Kolegji nisur nga këto rrethana vlerëson se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur, rrjedhimisht në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë", Kolegji konstaton së janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedurës administrative të filluar me ankesën me numër A.nr.500/2022 të datës 06.06.2022.

Bazuar si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.500/2022

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit Avokat
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

